



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 177, Datë 04.11.2020

“MBI

**KËRKESËN E SHOQËRISË “MOBIGAS ALBA” SH.P.K., PËR T’U TËRHEQUR NGA
APLIKIMI PËR T’U LICENCUAR NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË GAZIT
NATYROR (SHITJE ME SHUMICË)”.**

Në mbështetje të nenit 16 të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë Elektrike”, i ndryshuar, neneve 16, 64 dhe 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurës administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e datës 04.11.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 116/7 Prot, datë 30.10.2020, e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes mbi kërkesën e shoqërisë “MobiGas Alba” sh.p.k., për t’u tërhequr nga aplikimi për pajisje me licencë në veprimtarinë e tregtimit të gazit natyror (shitje me shumicë),

Konstatohet se:

- Bordi i ERE me vendimin Nr. 96, Datë 08.06.2020, vendosi: “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Mobigas Alba” sh.p.k, në veprimtarinë e tregtimit të gazit natyror (shitje me shumicë).
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 152/2020, vendosi të shtyjë afatin e vendimmarrjes finale për licencimin e shoqërisë “MobiGas Alba” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të gazit natyror (shitje me shumicë).
- Sa më sipër iu bë me dije shoqërisë me shkresën nr. 723/11 prot, datë 08.10.2020 dhe përveç kërkesës për plotësimin e dokumentacionit të munguar, iu kërkua të specifikojë/saktësojë mënyrën e operimit të veprimtarisë për të cilën ka aplikuar.
- Shoqëria “MobiGas Alba” sh.p.k., me shkresën e datës 20.10.2020, protokolluar në ERE me nr. 723/12 prot, datë 20.10.2020, ka kthyer përgjigje për sa kërkuar nga ERE , duke u shprehur, se nga korrespondenca e zhvilluar me ERE-n, si dhe nga vlerësimi sistematik i legjislacionit që rregullon licencimin e subjekteve për aktivitetet e ushtruara lidhur me depozitimin/impianetet e GNL, ashtu edhe për tregtimin e GNL nga ERE apo nga çdo autoritet tjetër licencues në Republikën e Shqipërisë, shoqëria ka arritur në përfundimin se ka një mangësi të dukshme në rregullimin e fushës së industrisë

së njohur ndryshe si “small LNG” ose “mini LNG”, ku karakteristikë kryesore e kësaj mënyre operimi është shtrirja në territore të pambuluara nga rrjeti i gazit apo tubacionet direkte.

- Në përfundim shoqëria ka deklaruar se nuk mund të përmbushë kërkesat e ERE-s për aplikimin e kryer për licencë.
- Duke qenë se aplikuesi është tërhequr nga kërkesa për licencim, në kuptim të parashikimeve të nenit 64 të Kodit të Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë, ka rënë shkaku ligjor për të cilin filloi kjo procedurë administrative.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Përfundimin e procedurës administrative për shqyrtimin e kërkesës e shoqërisë “MobiGas Alba” sh.p.k., për pajisje me licencë në veprimtarinë e tregtimit të gazit natyror (shitje me shumicë) mbështetur në kërkesën e aplikuesit.
2. Të shfuqizojë vendimin Nr. 96, datë 08.06.2020, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “MobiGas Alba” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të gazit natyror (shitje me shumicë).
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE

Petrit AHMETI